

AURELA BASHA,
RUDINA DYLGJERI

**SPROVË PËR NJË VËSHTRIM PRAGMAGJUHËSOR
TË THËNIEVE TE GRUPMOSHA 8-11 VJEÇ**

Thënia dhe kuptimi i saj, si produkt që përvijohet nga veprimtaria e të thënit (si akt ligjërimit), del nga marrëdhënia që ajo vendos me të thënë, që parakupton një hapësirë e një kohë, një orientim, një përcaktim... (Përnaska, Gjuhësi ...gjuhësore, 2015, f. 156). Ndaj, thënia, është prodhimi që përftohet në një situatë të caktuar ligjërimore (akt ligjërimit), nga një thënës (folës) që kërkon domosdo një dëgjues (bashkëfolës) dhe që ka një përmbajtje të caktuar (kuptimi/domethënia që përçohet). Thëniet, pra, janë të pajisura me një forcë shprehëse (*illocutoire*) që mund të qartësohet nga sintaksa, intonacioni ose konteksti (Përnaska, 2015, f. 167). Nga njëra anë, këto aspekte kanë të bëjnë me faktin se ajo nënkupton njëkohësisht praninë e një *'situate kumtimi'*, *'kontekst psikosociologjik'* të përfuturit dhe të aktualizimit të thënieve dhe si akt individual i përdorimit të gjuhës... (Përnaska, 2015, f. 167).

Në këtë kuptim thënia është sa individuale, aq edhe sociale, është prodhim sa gjuhësor, aq edhe ligjërimit.

Thënia trajtohet edhe për nga formëzimi, duke u ndalur në konceptet "thënie të formuara mirë", pra, që kanë një formëzim të mirë apo ndërtime të rregullta, dhe "thënia të paformëzuara mirë", pra, ndërtime jo të rregullta, përjashtime nga rregulli ose të pathënshme. Thëniet e rregullta profesor Remzi Përnaska i shpjegon nga pikëpamja e rregullsisë gramatikore dhe pajtueshmërisë me gjuhën, duke i lidhur ngushtësisht edhe me kuptimin si një përbërës mjaft i rëndësishëm që motivon edhe qëllimshmërinë gjatë aktit ligjërimit. Ndaj, në çdo thënie (por edhe fjali) aspekti gramatikor është i pandashëm nga ai semantikor.

Thëniet e mëposhtme janë shkëputur nga dialogë, diskutime e biseda në veprimtari mësimore për lëndë të ndryshme shkollore, si: gjuhë shqipe, edukatë shoqërore, vendlindje etj., në klasën 2-5 të tri shkollave të qytetit të Elbasanit, duke i transkriptuar ato me shkrim.

Këto thënie do të analizohen për nga formëzimi i tyre. Në formëzimin e tyre, siç pohuam më lart, luan rol qendror gërshetimi i aspektit gjuhësor

(leksiko-semantikor dhe gramatikor) me atë ligjërimor (kushtet dhe kriteret pragmatike dhe veçoritë e të folurit).

Për analizë janë marrë thënie në të cilat evidentohen gabime të natyrës leksikore e semantike, si edhe gramatikore që ndikojnë drejtpërdrejtë a tërthorazi në përfitim dhe përçimin e kuptimit/domethënies së tyre. Kjo analizë do të marrë në konsideratë edhe veçoritë e zhvillimit psikolinguistik të kësaj moshe.

Për përcaktimin e tipologjisë së këtyre gabimeve kemi operuar me anë të koncepteve kryesisht në fushë të semantikës leksikore (M. P. A. Llach. *A critical review of the terminology and taxonomies used in the literature on lexical errors. A list of terms and expressions for lexical error*. f. 23.), dhe gramatikës, si: *gabim në zgjedhjen leksikore, papërshtatshmëri në rrjetin leksikor, përafrim leksikor, konfuzion leksikor* (fjalë me formë të ngjashme [sinformat] janë ngatërruar, që do të thotë, një fjalë që është përdorur në vend të një fjale tjetër), *shmangia leksikore* (shmangiet normative të njësive leksikore), *thjeshtim leksikor, konfuzion semantik, shmangie semantike, shkarje semantike, devijimi semantik* (disa tipare semantike të një fjale që janë transferuar në mënyrë të gabuar te një fjalë tjetër e synuar), *gabime strukturore* (përbërja fonetike dhe morfemore e fjalës, sidomos e fjalëve të gjata, përbërja e fjalive, strukturës së fjalive), *gabime të fjalorit* (gabimet që kanë të bëjnë me faktet leksikore) etj.; *mungesa e koherencës semantike, mungesa e koherencës sintaksore* (*mungesa e koherencës kohore, mosrespektimi i akordimit të kohëve dhe mënyrave*) etj.

Mua më pëlqen qeni **sepse** [të ha] **dhe, që** hajdutët [i ha], **dhe që** [luaj] me të. (kl. 2)

Nga njëra anë, kemi të bëjmë me një ndërtim jogramatikor që sjell si rezultat një devijim semantik, madje dhe konfuzion semantik. Kjo vërehet fillimisht te përdorimi i lidhëzës bashkërenditëse shtuese *dhe*, për të lidhur dy pjesë të varura nga pjesa kryesore *mua më pëlqen qeni – (sepse) – të ha – (dhe) – i ha – (dhe) – luaj*. Përdorimi dy herë radhazi i lidhëzës bashkërenditëse shtuese *dhe* e ngarkon strukturën sintaksore të kësaj thënieje, duke ndikuar edhe te struktura semantike e saj.

Kjo thënie do të kuptohej më mirë nëse do t'i ndanim pjesët përbërëse të saj si thënie më vete: 1. *Mua më pëlqen qeni sepse [të ha] (të ruan, të mbron) dhe [i ha] (i sulet hajdutëve)*; 2. *Mua më pëlqen qeni sepse [luaj] (argëtohem) me të*; ose do të ruhej kjo strukturë sintaksore duke hequr vetëm përemrin lidhor *që* (meqenëse përemri lidhor *që* në këtë thënie nuk motivohet gramatikisht, as semantikisht) dhe njërin nga lidhëzat

bashkërenditëse *dhe* (marrëdhënie jolidhëzore): Mua më pëlqen qeni *sepse* [të *ha*], hajdutët [i *ha*] *dhe* [luaj] (*argëtohem*) me të.

Përdorimi i pamotivuar gramatikusht dhe semantikusht i përemrave lidhorë, trajtave të shkurtra të përemrit vetor etj., haset rëndom te thëniet e kësaj moshe. Ky përdorim dëshmon se nxënësit e kësaj moshe, por edhe të moshave të tjera shkollë, hasin vështirësi në të nxëniet dhe zotërimin e kompetencën sintaksore, sidomos në ligjërimin e folur. Kjo vështirësi argumentohet kryesisht me faktin se në këtë grupmoshë ende nuk është i qartë koncepti i lidhjeve bashkërenditëse shtuese, veçuese, kundërshtuese etj. (që nënkuptojnë lidhjen e dy njësive sintaksore që kryejnë funksion të njëjtë), dhe i lidhjeve nënrenditëse kohore, vendore, qëllimore etj. (ku njëra njësi sintaksore varet ose drejton një apo disa njësi të tjera sintaksore, të cilat kryejnë funksione të ndryshme).

Një rol të rëndësishëm në këto ndërtime gramatikore luan edhe sintaksa e të folurit që paraqet veçanti që kushtëzohen nga faktorë pragmatikë dhe vetë ligjërimi i folur, por edhe të natyrës psiko-gjuhësore: kontekstin, qëllimin, bashkëbiseduesit, shpejtësinë e rrjedhshmërinë e të folurit etj.

Në aspektin leksikor, përzgjidhet disa herë folja *ha*, përzgjedhje kjo që nuk i përshtatet kontekstit ligjërimor, por edhe strukturës semantike (argumentuese) të thënies.

Disa arsye për të argumentuar se pse ndodh kjo përzgjedhje mund të jenë: fjalori i varfër dhe i kufizuar i fëmijës së kësaj moshe (njohja dhe përdorimi vetëm i foljes *ha* me kuptimin *mbron*, *ruan*); ngulitja e gjedhit/gjedheve gramatikore (ku gjen përdorim fjala) që dëgjon e përdor fëmija në mjedisin gjuhësor përkatës; konkurrenca leksikore në rrafshin paradigmatic në leksikun mendor (përzgjedh fjalën që i vjen ndër mend e para në çastin e ligjërimin) etj.

[Unë *vij*] me Luisin *sepse* [na pëlqejnë] gjërat e njëjta. (kl. 2)

Duke iu referuar kontekstit përdorimor, prodhuesit të thënies (fëmijës 8 vjeç), dhe qëllimit të thënies, folja *vij* nuk e motivon semantikusht strukturën argumentuese të saj. Kjo ndodh për shkak të përzgjedhjes të papërshtatur, madje të pasaktë të kësaj foljeje, e cila jashtë kontekstit të thënies nënkupton një veprimi fizik (lëviz, kthehem, arrij, shkoj, dal etj.). Zëvendësimi i saj me foljet si: *qëndroj*, *shoqërohem*, *ndaj* etj., duke u mbështetur edhe në treguesit e mësipërm (konteksti, situata, folësi etj.), e qartëson kuptimin e saj dhe realizon për rrjedhojë edhe qëllimin kumtues të saj.

Në sintagmën emërore *gjërat e njëjtat*, nga pikëpamja kuptimore, kufizohet qarku i gjërave të përbashkëta që pëlqejnë, duke nënkuptuar një tërësi të kufizuar objektësh (përfytyrim konkret). Këtë argument e përforcon edhe theksi logjik që bie mbi fjalën *gjërat* (e njëjta) gjatë ligjëritimit të folur (intonacioni dhe kadenca e zërit).

Trajta e shkurtër e përemrit vetor *na* (neve na) në rasën dhanore, numri shumës e thekson dhe e përforcon marrëdhënien dyshe: *unë + ti = na* (neve) dhe jo të tjerët, pra, *mua dhe shokut tim dhe jo të tjerëve, ndryshe nga të tjerët, në veçanti nga të tjerët*.

Nëse do të ndryshonim vendet e fjalëve në sintagmën emërore nga *gjërat e njëjta* në *të njëjtat gjëra*, do të shihnim se kjo përmbysje raportesh semantike sjell edhe përfitim të një kuptimi të ri. Theksi logjik zhvendoset nga *gjërat*, në rastin e parë, tek mbiemri *të njëjtat*.

Mbiemri *të njëjtat* (gjëra) e zhvendos spektrin e gjërave nga bota sendore në atë mendore e shpirtërore (mendime, ide, dëshira, ëndrra, etj.). Përdorimi i foljes *pëlqejmë* (bëjmë, luajmë, preferojmë, kënaqemi, argëtohem, etj.) e motivon më mirë semantikisht sintagmën *të njëjtat gjëra* (domethënë jo vetëm objekte, sende, por edhe mendime, ide, dëshira etj.).

Mua më pëlqen sepse [është i përkëdhelur]. (kl. 2)

Krijohet një ambiguitet semantik për shkak të përzgjedhjes dhe lidhjes jo të përshtatur semantikisht të mbiemrit i *përkëdhelur* me foljen këpujë *është*. Ky ambiguitet ndikon në strukturën argumentuese të thënies duke nënkuptuar një cilësi të objektit (në rastin tonë *lepurit*) *është ledhatues/lozonjar*, dhe një veprim që kryhet nga vepruesi *mund ta përkëdhel/ledhatoj*.

[Një] është kuzhina ku ne rrimë. (kl. 3)

Kemi të bëjmë me një ndërtim jogramatikor, që sjell dhe konfuzion semantik. Thënia fillon me numërorin *një* që i referohet *kuzhinës* si pjesë e mjedisit fizik ku jeton fëmija, e në raport me këtë mjedis, pra veçohet kuzhina apo dhoma e ndenjes. Gjithashtu, ky ndërtim sintaksor nuk i shkon për shtat gjedhit gramatikor në gjuhën shqipe, si: *Kemi vetëm një kuzhinë a dhomë ndenjeje, ku rrimë së bashku, Ne rrimë në kuzhinë* etj. Ndërtime të tilla hasen shpesh në ligjërimin e fëmijëve të kësaj grupmoshe, madje edhe te më të rriturit. Një nga shkaqet e përdorimit të tyre është edhe ndikimi i mjedisit gjuhësor ku rritet dhe formohet gjuhësisht fëmija, apo i medies së folur dhe të shkruar, sipas gjedheve joshqip.

Ai ka shumë cilësi të mira, si për shembull, [dhe] [që] është besnik. (kl. 3)

Sprovë për një vështrim pragmagjuhësor të thënieve te grupmosha 8-11 vjeç

Në këtë thënie, sintagma emërore *cilësi të mira* i referohet cilësive të qenit, si kafshë *besnike*. Përdorimi i përemrit lidhor *që* dhe pjesëzës shtuese *dhe*, të pranëvënë me njëri-tjetrin përbën një gabim strukturor që sjell si rezultat edhe një shkarje semantike.

Një ndërtim i tillë nuk i shkon për shtat gjedhit gramatikor në shqip. Ndërtime të tilla sintaksore hasen rëndom në ligjërimin e folur te thëniet e fëmijëve të kësaj moshe dhe kushtëzohen shpesh edhe nga sintaksa e të folurit, e cila paraqet veçanti strukturore të dallueshme nga sintaksa e të shkruarit. Këto veçanti strukturore kushtëzohen nga faktorë të natyrës ligjërimore, pragmagjuhësore, psiko-emocionale etj., të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në formulimin e thënieve që për nga formëzimi i tyre gjuhësor mund të pasqyrojnë shmangie nga norma gramatikore, leksikore e drejtshqiptimore, pra, mund të jenë të pasakta, të paqarta e deri të pakuptimshme.

Atij i pëlqen [*loja me të kapme*]. (kl. 3)

Në këtë thënie konstatohet një përafrim leksikor si rezultat i mosnjohjes së emërimit të lojës ose zëvendësimit e përdorimit të një emërtimi tjetër (në aksin paradigmatic) si përbërës i fjalorit aktiv të fëmijës së kësaj moshe: *me të kapme* për *turravrap*, *syllambyllurazi* etj.

Një përdorim i tillë kushtëzohet edhe nga fjalori i përbashkët i kësaj moshe, variacioni gjuhësor a zhargoni (emrat e lojërave, veprimeve e rregullave të tyre etj.) që fëmijët njohin dhe përdorin së bashku dhe në mjedisin e përbashkët socio-gjuhësor, që mund të jetë i ndryshëm nga një variacion tjetër gjuhësor apo nga një moshë në tjetrën. P.sh. *loja me pafka*, *loja me peta*, *loja me një këmbë në katror* etj.

[*Kafsha ime e pëlqyer*] është qeni. (kl. 4)

Ndryshe nga rasti i mësipërm, nxënësi përzgjedh mbiemrin *e pëlqyer* që derivon nga folja *pëlqej*. Për arsye të një përafrimi leksikor në rrafshin paradigmatic (e preferuar), ose si një formë derivuese e mbiemrit nga folja (e pëlqyer/që pëlqej, preferoj), ai bën një përzgjedhje dhe përdorim të papërshtatur të mbiemrit *e pëlqyer* në strukturë sintagmatike *kafsha e pëlqyer*, duke sjellë si rezultat edhe një devijim semantik të thënies.

[Unë] (*mua*) qeni më pëlqen, *sepse* [*e kam fantazi*]. (kl. 4)

Në këtë thënie, vërehen probleme të natyrës gramatikore që sjellin si rezultat dhe paqartësi deri në moskuptimin e saj. Përdorimi i gabuar i përemrit vetor *unë* në rasën emërore në vend të *mua* në rasën dhanore sjell si rezultat një shmangie nga rregulli gramatikor dhe shkarje semantike në

pjesën e parë të thënies. Kjo shkarje semantike përforcohet nga për zgjedhja dhe kombinimi i papërshtatur i njësive leksikore *e kam fantazi*.

Tipologjia dhe struktura sintaksore e shqipes (R. Përnaska. Gjuhësigjuhësore. Maluka. *Me ndërtim (strukturë) kuptohet uniteti gramatikor i përbërë prej fjalësh, i cili ka formën e vet, d.m.th. ka skemë vetjake*, f. 119) e përjashton një ndërtim të tillë si: *unë/mua qeni më pëlqen apo qeni më pëlqen*. Duke qenë se lidhjet sintagmatike kushtëzohen nga kjo lloj tipologjie ndërtimore, edhe sintagma foljore *e kam fantazi* në vend të *e kam ëndërr* nuk motivohet semantikisht.

Formulime të tilla janë jogramatikore dhe e privojnë kuptimin e thënieve, të cilat bëhen shpesh të painterpretueshme.

Unë [*doja të merrja*] (= *dëshiroja*) një qen. Por babai dhe mamaja [*s'më lejnë*] (= *nuk më lejojnë*). Ato thonë se [i kanë inat] **ngaqë** [*lëshojnë push*] dhe mami [*e ka inat pushin*]. Unë [*e pranoj*] **sepse** [*s'kam bahçe*]. Mua ajo më pëlqente ngaqë edhe [*është e butë*] me mua. (kl. 4)

Në këtë paragraf të shkëputur nga dialogu me një nxënës të klasës së 4-ët vërehen disa probleme të natyrës gramatikore, leksikore e semantike. Vërehen fillimisht shmangie leksikore (norma leksikore), për arsye të përafrimit leksikor midis foljeve *lejnë* (lë) për *lejojnë* (lejoj) dhe ndikimi i ligjëritimit të përditshëm (thjeshtligjëritimi): *kanë inat* për *nuk i pëlqejnë*, *nuk i duan*, *nuk i durojnë dot*, *bahçe* për *kopsht etj*.

Në aspektin gramatikor vërehet mungesa e koherencës kohore që vjen si rezultat i mungesës së alternimit të kohëve të foljeve brenda një teksti të caktuar, si: *doja të merrja/s'më lejnë*.

Në aspektin leksikor, vërehen përzgjedhje të gabuara leksikore e për rrjedhojë edhe mospërshtatje semantike. Thënia *lëshojnë push* për *lëshojnë qime* dëshmon se në këtë grupmoshë vërehen raste të zëvendësimit të koncepteve me njëra-tjetrën mbi bazën e përafrisë të tipareve kuptimore në aksin paradigmatic. Këto përzgjedhje të gabuara ose të papërshtatura të njësive leksikore pasqyrohen më qartë në lidhjet e tyre kuptimore në strukturat sintagmatike: *është e butë me mua*, *e ka inat pushin*, por edhe në tërë strukturën semantike të thënies: *unë e pranoj sepse s'kam bahçe*, duke sjellë për rrjedhojë dhe shmangie semantike në tërë strukturën e thënies.

Mua më pëlqente gjuha [*sepse është e mirë*]. Ajo të zhvillon [*trurin*]. (kl. 4)

Në këtë thënie përzgjedhja e emrit *gjuha* në vend të *lënda e gjuhës* sjell një devijim semantik.

Sprovë për një vështrim pragmagjuhësor të thëniesve te grupmosha 8-11 vjeç

Kjo përzgjedhje jo e saktë e emrit *gjuha* ndikon në strukturën semantike të thënies. Ky devijim semantik theksohet nga struktura e sintagmës (sepse *është e mirë* – argumenti) duke mos e bërë të qartë qëllimin që synon të përçojë folësi.

Gjithashtu, vërehet një mungesë e koherencës semantike midis sintagmave foljore *më pëlqente gjuha* dhe *është e mirë* që lidhen me lidhëzën shkakore *sepse*. Mungesa e koherencës kohore mund të çojë në ambiguitet semantik, dhe para së gjithash për shkak të perceptimit të gjuhës si një koncept konkret (objekt a frymor) dhe jo si një koncept abstrakt (lënda e gjuhës).

Pjesa tjetër e thënies (pjesa e nënrenditur shkakore) *të zhvillon trurin* përbën një argument më vete në lidhje me parapëlqimin për lëndën e gjuhës. Edhe në këtë thënie vërehet i njëjti gabim si në disa raste më lart: përzgjedhja e papërshtatur e njësisë leksikore (konceptit) në strukturën sintagmatike *zhvillon + trurin/mendjen*.

Këto përzgjedhje të papërshtatura mund të ndodhin edhe për shkak të mosnjohjes së konceptit apo kuptimit përkatës të tij, ose ngulitjes së pasaktë të tij (konceptit apo kuptimit) në leksikun mendor e si rezultat dhe përdorimit të gabuar në ligjërim.

[*Të kesh miqësi do të zësh*] mik, mike apo shok, shoqe. (kl. 5)

Në këtë thënie vërehet një thjeshtimi sintaksor i strukturës së saj *Të kesh miqësi – do të thotë – të zësh...* që shkakton dhe paqartësi kuptimore e deri në vështirësi të përfuturit dhe interpretimit të kuptimit të mesazhit.

Thjeshtimi sintaksor, si në rastin e mësipërm, nuk është karakteristikë e gjuhës shqipe (siç mund të ndodhë në anglisht apo në ndonjë gjuhë tjetër). Duhet theksuar se nxënësit e kësaj grupmoshe, të ndikuar dhe nga mjedisi gjuhësor përkatës e sidomos bashkëmoshatarët dhe për shkak të shpejtësisë dhe rrjedhshmërisë së të folurit, shpesh shkurtojnë fjalët, shkrijnë ose heqin morfema të një fjale, fjalë a shprehje të një thënieje, të cilat pasqyrojnë shmangie nga norma gjuhësore (drejtshqiptimore e deri gramatikore). Media e folur dhe e shkruar ndikon gjithashtu në këto struktura sintaksore që nuk i përshtaten gjedhit gramatikor në shqip.

Mua, ajo [*më mëson rrugën drejt në jetë*]. (kl. 5)

Në aspektin semantik, në këtë formulim vërehet një ambiguitet kuptimor që shkaktohet nga përzgjedhja dhe lidhjet jo të përshtatura leksikore e kuptimore midis njësive leksikore përkatëse. Luan rol edhe tipologjia e strukturës sintaksore të thënies në ndërtimin *më mëson* -

rrugën - drejt - në jetë që nuk i përshtatet gjedhit gramatikor në shqip, duke sjellë këtë ambiguitet e deri vështirësi në interpretimin e saj.

Fjala *rrugë* si koncept konkret nuk realizon lidhje e raporte të përshtatura e të qarta semantike me njësitë e tjera (që përdoren me kuptim abstrakt e të figurshëm). Në rastin e mësipërm këtë ambiguitet e shkaktojnë së pari, marrëdhëniet kuptimore që vendosen midis fjalëve *rrugë* dhe *jetë*, pra midis një koncepti konkret dhe një koncepti abstrakt. Të njëjtën gjë mund të pohojmë edhe për përdorimin e ndajfoljes së mënyrës *drejt*, që në një kontekst tjetër mund të merret edhe si parafjalë *drejt në jetë*.

Nga ana tjetër, përdorimi i emrit *rrugë* me kuptim të figurshëm dhe si koncept abstrakt kushtëzohet edhe nga natyra e lidhjeve gramatikore dhe raporteve kuptimore me njësitë e tjera në këtë ndërtim, siç është pranëvënia dhe lidhja gramatikore me ndajfoljen e mënyrës *drejt* (jo me dredhi, jo shtrembër), me kuptim të figurshëm.

Në aspektin psikolinguistik, zhvendosja e kuptimit dhe tipareve kuptimore (nga ai konkret në atë abstrakt dhe anasjelltas) kushtëzohet nga veçoritë e të menduarit të kësaj grupmoshe (të menduarit konkret dhe abstrakt).

Në aspektin pragmagjuhësor ajo lidhet me shkallën e zotërimit të kompetencës gjuhësore dhe përbërësve të saj, si edhe të kompetencës konjitive e pragmatike. Nën ndikim e këtyre faktorëve fëmija formulon thënie të sakta ose të pasakta, të kuptimshme ose të pakuptimshme.

Ndër të tjera, një rol të rëndësishëm në përfitim të thënieve të formëzuara mirë gramatikisht dhe me kuptim, bart edhe aftësia që nxënësi kultivon në shkollë për të përzgjedhur e kombinuar njësitë leksikore në struktura sintagmatike, sintaksore e semantike.

Të ngjashëm e të përafërt në problematikë e në interpretim janë edhe rastet: *Miqësia [të ndihmon]* gjithmonë në jetë; Në liqen [*notojnë*] varka; [*Miqësia më pëlqen*] shumë; *Miqësia për mua [është një pikë e fortë]*, sepse *më ndihmon* kur luaj futboll; *Miku im është [një shpatull e madhe]* për mua; Të jesh [*mik i njërit*] do të thotë të jesh edhe ti [*mik i tij*]; Pa miq [*s'ka jetë*]; Shoku i mirë [*përbën një miqësi të mirë*] etj.

Unë mendoj *se* në të ardhmen [*të bëhem*] arkitekt. (kl. 5)

Në këtë thënie, kemi një ndërtim jo të saktë gramatikor, që ka të bëjë me përdorimin e gabuar të lidhëzës filluese *se* në një strukturë sintaksore me marrëdhënie kundrinore.

Marrëdhëniet kundrinore në këtë ndërtim, do të motivohej gramatikisht dhe semantikisht nëse ndërkëmbejmë lidhëzën filluese *se* me lidhëzën

filluese *që*. Lidhëzat **që** dhe **se** përgjithësisht ndërkëmbehen; por **që-ja** nuk ndërkëmbehet me **se-në** kur fill pas saj vjen folja kallëzues *në lidhore*; gjithashtu **se-ja** nuk ndërkëmbehet me **që-në** kur fill pas saj vjen një *fjalë pyetëse*. (M. Çeliku, M. Karpinjalli, M. Stringa, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*. 1998:440.) Ky rregull na orienton në drejt një interpretimi sa më të motivuar të kuptimit të kësaj thënieje.

Ndërkëmbimi i tyre bën të mundur realizimin e koherencës sintaksore dhe semantike të saj. Kështu, nga ky ndërkëmbim do të përftojmë dy thënie të ndryshme me kuptime të ndryshme.

Në përfitim të këtyre kuptimeve do të na ndihmojnë kategoritë gramatikore të mënyrës dhe kohës së foljes. Këto thënie janë: 1. *Unë mendoj se në të ardhmen do të bëhem arkitekt*, dhe 2. *Unë mendoj që në të ardhmen të bëhem arkitekt*.

Duke u mbështetur në analizën e shembujve të mësipërm mund të pohojmë se në çdo formulimin gjuhësor të folur apo të shkruar, përzgjedhja e njësive leksikore në rrafshin paradigmatic dhe kombinimi i tyre në atë sintagmatik i nënshtrohet rregullave gramatikore të gjuhës përkatëse, lidhjeve kuptimore, kushteve dhe parimeve pragmatike, si edhe veçantive të zhvillimit psiko-gjuhësor të çdo grupmoshe.

Thënia si njësi gjuhësore dhe ligjërimore, mbetet të studiohet në një dimension ndërdisiplinor (e jo vetëm gjuhësor), dhe t'i kushtohet më shumë rëndësi thënies dhe veprimtarisë së të thënit te moshat e ndryshme shkollore në procesin mësimor, me qëllim që fëmijët, nxënësit e këtyre moshave të shprehen saktë, qartë e bukur në gjuhën shqipe duke dëshmuar një kulturë të pasur jo vetëm gjuhësore, por edhe enciklopedike.

BIBLIOGRAFI

- Ballhysa, A., *Çështje të standardit dhe edukimi gjuhësor në shkollë*, Studime Shqiptare, Shkodër 2003.
- Ballhysa, A., *Probleme të standardit gjuhësor dhe aftësisë komunikative të moshës së ulët shkollore*, SNGJLKSH 20/1, ASH-IGJL&UP-FF, Prishtinë, 2002.
- Ballhysa, A., *Të nxënësit e shqipes standarde në shkollë* - Seminari ndërkombëtar i Prishtinës, Gusht 2009.
- Cellier, M., *Le vocabulaire à l'école primaire*, Retz, 2008; Vancomelbeke, *Enseigner le vocabulaire*, Nathan, 2004. Nga vepra ku janë përfshirë punimet e tyre: *L'enseignement et l'apprentissage du vocabulaire à l'école primaire. Quel lien avec la littérature?* IEN Marvejols – Octobre, 2011.

- Crain, S., Thornton, R., *Acquisition of Syntax and Semantics. Section 3: Language Development*. Handbook of Psycholinguistics. Second Edition, 2006. Isbn-13:978-0-12-369374-7. www.ucd.ie
- Fjalori i Shqipes së Sotme, Botime Toena, Tiranë, 2002.
- Florin, A., *Les connaissances lexicales des enfants d'école primaire*. Université De Nantes Laboratoire De Psychologie "Éducation, Cognition, Développement" <http://ife.ens-lyon.fr>
- Il linguaggio e il pensiero del fanciullo*, Firenze, Editrice Universitaria, 1955.
- Language in the Primary School*. Primary English Curriculum. www.into.ie
- Llach, M. P. A., *A Critical Review of the Terminology and Taxonomies Used in The Literature On Lexical Errors. A list of terms and expressions for lexical error*. www.misclaneajournal.net
- Përnaska, R., "Gjuhësi... gjuhësore. Shtypshkronja Maluka, 2015.
- Plangarica, T., *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*. Sejko, 2002.
- Plangarica, T., *Cikël leksionesh. Hyrje në studimin e kuptimit. Semantikë dhe pragmatikë. Nga Sandrine Zufferey dhe Jacques Moeschler*.
- Scovel, Th., *Psycholinguistics*. Oxford Introductions to Language Study. Series Editor F. F. Widdowson. ISBN 0 19 4372138. Oxford University Press, 1998 (First published).
- Slama – Cazacu, T., *Linguistique Appliquée: Une Introduction....*, Brescia 1984
- Thomai, J., Samara, M., Sinani, A., *Fjala shqipe dhe shkolla jonë*, "Gjuha jonë", VII.2/1987.